



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 12054 Prot.

Tiranë, më 30.04. 2021

Të dhëna mbi Vendimin

Nr.49, datë 30.04.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/ç i Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Anri Ashensor" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale, në kontratën me objekt: "**Shërbimi i mirëmbajtjes së ashensorëve të SUT**", të nënshkruar nga Spitali Universitar i Traumës (në vijim "AK").

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (ligji aktual në fuqi).

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Anri Ashensor" Shpk, me NIPT L61830027K me adresë: Rruga "Thoma Koxhaj", banesë private Nr. 97, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Anri Ashensor" Shpk, ka nisur për mospërbushje të detyrimeve në minikontratën Nr. 11/20 prot., datë 22.09.2020 me objekt: "**Shërbimi i mirëmbajtjes së ashensorëve të SUT**" nënshkruar nga AK, i cili ka kërkuar nga APP, përjashtimin e operatorit ekonomik "Anri Ashensor" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/ç të LPP.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, në mbështetje të nenit 13/3/ç LPP, në të cilin parashikohet se: "**Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për: ç) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit**".

APP arsyeton se, gjatë zhvillimit të këtij procedimi administrativ, në 31 Mars 2021 ka nisur të shtrijë efektet e Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon masa më lehtësuese, sa i takon masës së dënimit që aplikohet për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga e drejta për të përfituar kontrata publike.

Konkretisht, në bazë të nenit 78/1/b të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, parashikohet se: “*APP përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik*”.

III.Masat:

Me Vendimin Nr. , datë _____. _____.2021, APP ka vendosur të përjashtojë për 10 (dhjetë) muaj operatorin ekonomik “Anri Ashensor” Shpk me NIPT L61830027K nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që, operatori ekonomik “Anri Ashensor” Shpk, nuk ka precedentë të mëparshëm për përjashtim nga pjesëmarrja në prokurimet publike. Ndërkohë, si rrethanë rënduese konsiderohet fakti që me mosveprimet e tij, duke mospërmbushur kontratën, operatori ekonomik ka dëmtuar interesat e AK në plotësimin e nevojave të tij në kohë për riparimin e ashensorëve, veçanërisht nëse mbahet në konsideratë fakti që AK në rastin konkret është spital publik.